

Eurona Leka është diplomuar në Universitetin La Sapienza, Romë Itali, në Fakultetin e Shkencave Politike me specializim në Marrëdhënie Ndërkombëtare, në vitin 2005, me rezultate të shkëlqyera dhe në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, në Elbasan, në Fakultetin e Shkencave Humane me specializim Gjuhë Shqipe, në vitin 2009. Ajo mban titullin Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare (MA) me profil në misione paqeruajtëse dhe menaxhimin e konflikteve nga Universiteti i Torinos, Itali në vitin 2008, vlerësuar gjithashtu shkëlqyeshëm.

Znj. Leka, ka një eksperiencë 10-vjeçare si pedagoge e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe të Drejtat e Njeriut në Universitetin Marin Barleti. Znj. Leka ka punuar si koordinatore për programe të ndryshme të organizatave ndërkombëtare si PNUD, ECHO, WFP dhe OSBE; si edhe spikat për ekspertizën e saj në menaxhimin e projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ajo i përqendron studimet e saj në fushat e të drejtave të njeriut, çështjeve ndërkombëtare dhe studimeve politike. Ajo ka prezantuar rreth këtyre temave në konferenca të ndryshme shkencore ndërkombëtare